



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I QARKUT VLORE

Nr. 114 prot

Vlorë më 10/07/2024

VENDIM

Nr. 12 datë 09/07/2024

**PËR MIRATIMIN E MBËSHTETJES FINANCIARE PËR AKTIVETET DHE  
NDRYSHIM DESTINACIONI PËR TRANSFERTËN E BASHKISË DELVINË**

*Në mbështetje të Ligjit 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", neni 77, Ligjit Nr. 9936, dt.26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, Në zbatim të Ligjit "Për Buxhetin e vitit 2024" Vendimit të Këshillit Të Qarkut nr.16 datë 27.12.2023 Për miratimin e buxhetit të Këshillit të Qarkut Vlorë për vitin 2024" në Akt-Marrëveshjet e nënshkruara, Vendimit të Këshillit Të Qarkut nr.2 datë 26.03.2024 Për disa shtesa dhe ndryshime ne buxhetin e Keshillit te Qarkut te vitit 2024,miratuar me VëKQ Nr.16 dt 27.12.2023."Shkresa Nr.1460 datë 03.07.2024 protokolluar me tonën Nr.1089 datë 05.07.2024"*

**VENDOSI :**

- 1.Të miratojë aktivitetet e parashikuara pa ndryshime financiare në buxhet sipas relacionit bashkëlidhur.
- 2.Të miratojë kërkesën e Bashkise Delvinë për ndryshim destinacioni të transfertës me vlerëe 5,000,000 lekë për "Rikonstruksionin e rrugës hyrëse së Qendrës Administrative Vergo,Delvinë", në zërin "Blerje materiale ndërtimi për sistemim e shtrim rruge e sheshe Njësia Administrative Vergo,Delvinë" ,pa ndryshime financiare.

**Adresa:** Këshilli i Qarkut Vlorë  
Pallati i Kulturës "Labëria" Vlorë  
Vlorë (AL), 9401

**Website:** [www.qarkuvlore.gov.al](http://www.qarkuvlore.gov.al)  
**E-mail:** [info@qarkuvlore.gov.al](mailto:info@qarkuvlore.gov.al)  
**Tel:** +355 33 421 600



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KËSHILLI I QARKUT VLORË**

3.Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Sektori I Urbanistikës,Zhvillimit të territorit,Burimeve Njerëzore,Arsimit,Kulturës,Turizmit dhe Cështjeve Sociale dhe Sektori Financë Buxhetit dhe Shërbimeve.

4.Ky vendim hyn në fuqi sipas parashikimit të Ligjit 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore, i ndryshuar, neni 78 pika 3.

**KRYETARI**

**Ervis Mocka**

*Shpallur nga Prefekti i Qarkut Vlorë me shkresë nr \_\_\_\_\_ prot, dt \_\_\_\_\_/\_\_\_\_\_/2024*

**Adresa:** Këshilli i Qarkut Vlorë  
Pallati i Kulturës "Labëria" Vlorë  
Vlorë (AL), 9401

**Website:** [www.qarkuvlore.gov.al](http://www.qarkuvlore.gov.al)  
**E-mail:** [info@qarkuvlore.gov.al](mailto:info@qarkuvlore.gov.al)  
**Tel:** +355 33 421 600



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KËSHILLI I QARKUT VLORE**  
**SEKTORI URBANISTIKËS ZHVILLIMIT TË TERRITORIT BURIMEVE**  
**NJERËZORE, ARSIMIT, KULTURËS, TURIZMIT, ÇËSHTJEVE SOCIALE**

**Relacion për mbështetje financiare mbi aktivitetet**

Në zbatim të Ligjit “Për Buxhetin e vitit 2024” Vendimit të Këshillit Të Qarkut nr.25 datë 22.12.2023 Për miratimin e buxhetit të Këshillit të Qarkut Vlorë për vitin 2024” në Akt-Marrëveshjet e nënshkruara dhe bazuar në kërkesat e ardhura të bashkive Delvinë, Selenicë dhe Himarë po ju paraqes relacionin si më poshtë:

Bashkia Selenicë ka paraqitur kërkesën për bashkëpunim me nr. 1040 Prot datë 27.06.2024 për aktivitetin “Edicioni i dytë i Festivalit Folklorik të Zonës” në datat 08-09-10 Gusht 2024 në të cilën kërkon të financohet në një nga zërat sipas preventivit bashkëlidhur shkresës.

Bashkia Delvinë ka paraqitur kërkesën për mbështetje financiare me nr. 1000 Prot datë 20.06.2023 për aktivitetin “Traditë, Kulturë, shije Delvinjote” në datën 09-10 Gusht 2024 në të cilën kërkojnë të financohen për mbulimin e një pjese të aktivitetit.

Bashkia Himarë ka paraqitur kërkesën për mbështetje financiare për aktivitetin “Candlelight by Sol” në datat 26-27-28 Korrik 2024 në të cilën kërkohet bashkëfinancim për disa nga zërat e preventivit bashkëlidhur kërkesës.

Për sa më sipër kërkojmë miratimin tuaj me qëllim që të përmbushet misioni i Këshillit të Qarkut Vlorë për të qënë pjesë dhe për të mbështetur të gjitha bashkitë të cilat janë pjesë përbërëse e qarkut Vlorë.

**Konceptoi:**

Ilda Lamaj

Specialist për Arsimin, Kulturën, Turizmin, Çështjet Sociale dhe Zhvillimin e Projekteve

**Miratoi:**

Anisa Hyseni

Përgjegjëse Sektorit Financ/Buxhet/Shërbime

**Adresa:** Këshilli i Qarkut Vlorë  
Pallati i Kulturës “Labëria”  
Vlorë

**Website:** [www.qarkuvlore.gov.al](http://www.qarkuvlore.gov.al)  
**E-mail:** [info@qarkuvlore.gov.al](mailto:info@qarkuvlore.gov.al)  
**Tel:** +355 33 421 600



1089  
05.07.2024

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA DELVINË  
KRYETARI

Nr. 1460 prot.

Delvinë, më 03.07.2024

KËSHILLIT TË QARKUT  
VLORË  
RELACION

I nderuar Kryetar i Këshillit të Qarkut Vlorë , të nderuar Këshilltar!

Bashkia Delvinë fal bashkëpunimit me ju , ka përfituar një fond prej 5.000.000 ( pesë milion) lekë për objektin “Rikonstruksion i rrugës hyrëse së Qendrës Administrative Vergo , Delvinë” fonde këto që janë alokuar nga Këshilli i Qarkut Vlorë. sipas Aneks – Marreveshjes nr.1316.Prot, datë 14.06.2024 me protokollin e tyre , në llogarinë e Bashkisë Delvinë pranë Degës së Thesarit Delvinë.

Nga një takim që kemi pasur me Drejtorin e Autoritetit Rrugor Shqiptar, na është komunikuar se ky segment , pra rruga hyrëse në qendrën të Njësisë Administrative Vergo, është planifikuar të financohet nga buxheti i tyre.

Sa më lart, kërkojmë bashkëpunimin dhe miratimin tuaj që fondet e alokuara nga Këshilli i Qarkut Vlorë , për objektin “Rikonstruksion i rrugës hyrëse së Qendrës Administrative Vergo , Delvinë” te shkoi në zërin “ Blerie materiale ndërtimi për sistemim e shtrim të rrugë e sheshe Njësia Adm. Delvinë”.

Ju faleminderit !

KRYETARI I BASHKISË

Besmir Veli

